



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 nëntor 2019
Nr. ref.: RK 1469/19

VENDIM PËR TËRHEQJE TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI82/19

Parashtrues

Izet Ahmetxhekaj

**Vlerësim i kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës për
vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të
Gjykatës Supreme të Kosovës A.nr.664/2010, të 29 marsit 2011 dhe
Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Istog, C.nr.96/016,
të 15 prillit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Izet Ahmetxhekaj, me vendbanim në Rudicë, Komuna e Klinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Sefer Desku, Avokat në Klinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës [në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme] A.nr.664/2010 i 29 marsit 2011 dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, dega në Istog (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) C.nr.96/016 i 15 prillit 2019.
3. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata tërheqjen e kërkesës së tij.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuar me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa Individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 maj 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
7. Më 28 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 18 qershor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të njoftojë Gjykatën nëse kishte përdorur ndonjë mjet juridik në lidhje me Aktvendimin C.nr.96/016 të Gjykatës Themelore, të 15 prillit 2019, si dhe të dorëzojë në Gjykatë të gjitha vendimet në lidhje me rastin e tij të cilat nuk i kishte bashkangjitur në kërkesën fillestare.
9. Më 7 korrik 2019, Gjykata pranoi një shkresë nga parashtruesi i kërkesës me të cilën ai e njoftoi Gjykatën lidhur ankesën që kishte paraqitur kundër Aktvendimin C.nr.96/016 të Gjykatës Themelore, të datës 15 prill 2019. Këtë shkresë ai e kishte dorëzuar në Postën e Kosovës, më 3 korrik 2019.

10. Më 12 korrik 2019, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme dhe Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 23 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesën për tërheqjen e kërkesës KI82/19, duke theksuar se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AC.nr.2392/19] të 17 korrikut 2019, ka *“aprovuar ankesën e [parashtruesit të kërkesës], si të bazuar dhe prishet Aktvendimi [C.nr.96/016], i Gjykatës Themelore [...] dhe lënda kthehet në rigjykim [...]”* në Gjykatën Themelore.
12. Më 7 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta aprovojë kërkesën për tërheqje të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve lidhur me kërkesën KI82/19

13. Parashtruesi i kërkesës kishte qenë i punësuar në Qendrën Korrektuese në Dubravë si oficer korrektues nga viti 2001.
14. Gjykata vëren se ndaj parashtruesit të kërkesës ishin zhvilluar tri (3) procedura:
 - i) Procedura penale me të cilën parashtruesi i kërkesës u lirua nga akuza penale, lidhur me veprën penale të përcaktuar me nenin 314 [Mundësimi i arratisjes së personit të privuar nga liria] në lidhje me nenin 23 [Bashkëkryerja] të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK), pasi dyshohej se më 15 korrik 2007, së bashku me disa persona të tjerë, u kishin mundësuar disa të burgosurve të arratisen nga burgu. Kjo procedurë përfundoi me Aktgjykimin Gjykatës së Apelit, [PA1.nr.135/15] të 23 shkurtit 2015.
 - ii) Procedura në lidhje me shkëputjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se pas lirimit nga paraburgimi në lidhje me procedurën penale të cekur më lart, parashtruesi i kërkesës nuk ishte paraqitur në vendin e punës dhe kjo sjellje kishte rezultuar me mospërfillje të detyrës sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Kosovës. Lidhur me këtë procedure parashtruesi i kërkesës kontestoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [A.nr.664/2010] të 29 marsit 2011, që miratoi padinë e Qeverisë së Kosovës dhe anuloi vendimin e KPMK [nr.1409/2010]; dhe
 - iii) Procedura në lidhje me padinë e parashtruesit të kërkesës për kthimin në punë dhe pagimin e të ardhurave personale, në lidhje me të cilën Gjykata Themelore, me Aktvendimin [C.nr.96/016] të 15 prillit 2019, hodhi poshtë padinë e parashtruesit si të palejuar. Ndaj këtij Aktvendimi parashtruesi kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit.

Kërkesa për tërheqje të kërkesës KI82/19

15. Parashtruesi arsyeton kërkesën e tij për tërheqjen e kërkesës KI82/19 me faktin se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AC.nr.2392/19] të 17 korrikut

2019, ka aprovuar ankesën e tij kundër Aktvendimit [C.nr.96/016] të Gjykatës Themelore dhe lëndën e tij e ka kthyer në rigjykim.

Vlerësimi i kërkesës për tërheqje të kërkesës KI82/19

16. Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesave, Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
17. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, duke marrë parasysh kërkesën e parashtruesit për tërheqjen e kërkesës së tij, Gjykata së pari do të bëjë shqyrtimin e kësaj kërkesë për tërheqje dhe në këtë aspekt, ajo së pari i referohet dispozitave përkatëse ligjore dhe të Rregullores së punës, si në vijim:

Neni 23 [Tërheqja e palës]

“Gjykata Kushtetuese do të vendos për çështjet që u janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura.”

Rregulli 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

“(1) Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.

(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me kërkesën.”

18. Gjykata vëren që paragrafi (1) i rregullit 35 të Rregullores së punës, i mundëson parashtruesve të kërkesave që a) para fillimit të seancës dëgjimore, ose b) para marrjes së vendimit nga Gjykata, të tërheqin kërkesën e tyre. Gjykata në bazë të nenit 23 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 35 të Rregullores së punës, vendos për miratimin ose jo të kësaj kërkesë.
19. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se nuk ka ndonjë arsye bindëse për vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë të aktvendimit të lartcekur, përkundër kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës së tij (shih, gjithashtu, rastin nr. K104/17, parashtrues Z. K., Vendim për tërheqje të kërkesës, i 28 korrikut 2017, paragrafi 19 dhe rastin nr. K110/17, parashtrues *Sekule Stanković*, Vendim për tërheqje të kërkesës, i 13 qershorit 2018, paragrafi 18).
20. Rrjedhimisht, Gjykata miraton kërkesën e parashtruesit për tërheqje të kërkesës në pajtim me nenin 23 të Ligjit dhe rregullin 35 të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 23 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 35 të Rregullores së punës, më 7 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË MIRATOJË kërkesën për tërheqjen e kërkesës nr. KI82/19;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi